



RAPORTI I PROGRESIT TË KOMPAKTIT

VLERËSIMI I PROGRESIT PËR PERIUDHËN GUSHT 2015 - QERSHOR 2016



Tabela e Përmbajtjes

Parathënie.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	5
KOMPAKT 2, 14 maj 2015	8
POLICIA & DOGANA	12
Ekuilibri etnik në institucionet e sundimit të ligjit	12
Krimet ndëretnike	13
Inspektorati Policor i Kosovës	15
Bashkëpunimi në mes të PK-së dhe Prokurorisë së Shtetit	16
PK-ja në pjesën veriore të Kosovës	17
Menaxhimi i kufirit	19
Kontrolli i Kufirit të gjelbër.....	21
Mbrojtja e dëshmitarëve	22
DREJTËSIA.....	23
Shërbimi Korrektues i Kosovës.....	23
Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë	25
Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.....	27
Luftimi i korrupsionit.....	29
Agjencia Kosovare e Pronës	30
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	31
ZBATIMI I DIALOGUT.....	33
Regjistri civil	33
Liria e lëvizjes	35
Menaxhimi i integruar i kufirit	36
Integrimi i strukturave të sigurisë	37
Drejtësia	38
Njësia e PK-së për trashëgimi fetare dhe kulturore.....	39
Lista e akronimeve dhe shkurtesave.....	40

Parathënie

Kemi nderin ta prezantojmë Raportin e katërt të Progresit të Kompaktit në të cilin i theksojmë të arriturat në saje të përpjekjeve të përbashkëta në Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit, të përbërë nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, EULEX-i dhe Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në Kosovë/Zyra e BE-së në Kosovë.

Në këtë raport përfshihet periudha prej gushtit 2015 deri në qershor 2016 – viti i fundit i mandatit 2014-2016 të EULEX-it – para se angazhimi i Misionit me homologët e vet të Kosovës të ndryshonte për shkak të mandatit të ri. Prioritetet e përfshira në këtë raport janë përkufizuar në marrëveshjen KOMPAKT, një marrëveshje ndërmjet të gjithë akterëve të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit, i cili bazohet në themelet e punës së përbashkët e cila pasqyrohet në këtë raport. Kjo është marrëveshja e dytë KOMPAKT, për këtë arsye është emërtuar si KOMPAKTI 2. Po ashtu është edhe raporti përfundimtar i cili e përfshin KOMPAKTIN 2, në periudhën prej korrikut 2016 e më tej, e cila përfshihet me marrëveshjen e re.

KOMPAKTI 2 është nënshkruar më 14 maj 2015 dhe shpreh zotimin e të gjithë akterëve të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit që të punojnë së bashku drejt përmirësimit të mekanizmave kryesorë institucionalë bashkërendues në Kosovë dhe të vazhdojnë me përpjekjet e bashkërenduara për reforma të BE-së në fushën më të gjerë të sundimit të ligjit në Kosovë. Nënshkruesit e këtij dokumenti janë ish-ministri i Drejtësisë i Kosovës Hajredin Kuçi, ish-kryesuesi i Këshillit Gjyqësor së Kosovës Enver Peci, ish-kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës Aleksandër Lumezi, ish-Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së /Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë Samuel Žbogar dhe ish-shefi i Misionit EULEX Gabriele Meucci. Autorët e këtij dokumenti janë pasuesit e zyrtarëve të përmendur më lart dhe janë të përkushtuar ta përshpejtojnë punën e përbashkët.

Siç u përshkrua më sipër, ky Raport i Progresit të Kompaktit shënon një periudhë të rëndësishme kohore: fundin e mandatit të mëparshëm të EULEX-it në qershor 2016 dhe fillimin e mandatit të ri i cili e zgjatë praninë e Misionit në Kosovë deri në qershor 2018. Prandaj, qëllimi i këtij Raporti të Progresit të Kompaktit është i dyfishtë: në njërën anë, ai i thekson dhe nënvizon të arriturat e partnerëve të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit deri në

këtë pikë; në anën tjetër, i thekson fushat vendimtare në të cilat duhet të bëhen përpjekje më të mëdha. Po ashtu shërben si bazë për dy vjetët e ardhshme të punës së përbashkët të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit.

Gjatë periudhës së raportimit (gusht 2015 deri qershor 2016), janë arritur disa objektiva të rëndësishme dhe është bërë përparim i konsiderueshëm. Edhe pse ende mbetet për t'u bërë shumë punë, puna e institucioneve të Kosovës ka treguar potencial të madh dhe janë bërë përmirësime të rëndësishme. Vetëm institucionet e qëndrueshme mund t'i vendosin standartet e sundimit të ligjit në mënyrë efektive dhe BE-ja mbetet e përkushtuar që ta mbështesë Kosovën në mënyrë të vazhdueshme për ta arritur këtë qëllim.

Ne, të nënshkruarit më poshtë, shpresojmë që lexuesi mund ta ndajë me ne entuziazmin tonë për mundësitë para nesh dhe do ta lexojë këtë Raport për Progresin e Kompaktit me kënaqësi.

Zëvendëskryeministri

Hajredin Kuçi

Kryesuesi i Këshillit
Gjyqësor të Kosovës

Nehat Idrizi

Udhëheqësja e Misionit
Evropian për Sundimin e
Ligjit në Kosovë

Alexandra Papadopoulou

Ministrja e Drejtësisë e
Kosovës

Dhurata Hoxha

Kryesuesi i Këshillit
Prokurorial të Kosovës

Blerim Isufaj

Përfaqësuesja e Posaçme e
BE-së në Kosovë /
Udhëheqësja e Zyrës së
BE-së në Kosovë

Nataliya Apostolova

Përmbledhje ekzekutive

Ky Raport i Progresit të Kompaktit shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë që nga nënshkrimi i KOMPAKT 2 në maj 2015. I shqyrton përmirësimet si edhe sfidat e mbetura në sundimin e ligjit në Kosovë gjatë periudhës së mandatit të mëparshëm të EULEX-it prej gushtit 2015 deri në qershor 2016.

Po ashtu vendos një bazë për Raportin e ri të Progresit të Kompaktit, i cili e pasqyron mandatin e ri të EULEX-it, inkurajon një përgjegjësi të shtuar të institucioneve të Kosovës për ta zbatuar dhe për ta zhvilluar më tej sundimin e ligjit në Kosovë.

Deri më tani nuk ka ndryshuar asgjë në zotimin e përbashkët të KOMPAKTIT. Qëllimi i përbashkët i Kosovës, i Përfaqësueses së Posaçme të BE-së/Zyrës së BE-së në Kosovë dhe i EULEX-it gjatë viteve në vijim mbetet i njëjtë: institucione për sundimin ligjit që janë të qëndrueshme, të përgjegjshme, të pavarura dhe shumetnike, pa ndërhyrje politike dhe të cilat i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikatat më të mira evropiane.

Gjatë periudhës së fundit të raportimit janë arritur një numër i objektivave të rëndësishme. Institucionet e Kosovës janë gjithmonë e më shumë në gjendje të merren vetë me sfidat e sundimit të ligjit. Dogana e Kosovës ka arritur përparim të konsiderueshëm, duke e përmirësuar mbledhjen e të hyrave si edhe aftësitë funksionale. Kushtet e organizimit për udhërrëfyesin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit janë plotësuar dhe Drejtoria e Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është gati të merret me dëshmitarin e parë të saj.

Policia e Kosovës gjithmonë e më shumë po shihet si shërbim profesional publik i cili i përfshin të gjitha pakicat etnike. Qendra e Paraburgimit e Mitrovicës është duke funksionuar relativisht mirë dhe prej periudhës së fundit të raportimit janë përmirësuar problemet e mungesës së stafit me të cilat përballej ajo. Megjithatë bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit duhet të përmirësohet edhe më, në mënyrë specifike lidhur me funksionimin ndërmjet tyre gjatë hetimit të krimit të rëndë dhe të organizuar, si edhe për çështjet siç janë terrorizmi, krimet nga urrejtja, dhe dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini.

Ndërkohë, përparimi i arritur në zbatimin e marrëveshjeve të ndryshme nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja ka ndihmuar në përparimin e institucioneve. Drejtoria Rajonale e Policisë e Mitrovicës së Veriut me katër stacione policore, nga një në secilën prej komunave veriore, është plotësisht funksionale. EULEX-i vazhdon t'i mbështesë aftësitë për kontrollin e turmës dhe të trazirave në Mitrovicë të Veriut, si edhe ta rrisë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet Drejtorisë Rajonale të Policisë të Mitrovicës së Jugut lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin e turmës dhe të trazirave. Integrimi i personelit të mëparshëm të MUP-it (Ministrisë serbe të Punëve të Brendshme) në strukturat e Policisë së Kosovës dhe integrimi i 483 pjesëtarëve të stafit të Mbrojtjes Civile në institucionet e ndryshme të Kosovës tashmë ka përfunduar.

Procesi i përzgjedhjes i prokurorëve dhe i gjyqtarëve serbë të Kosovës, i lehtësuar nga EULEX-i, ka përfunduar. Bashkëpunimi ndërmjet stafit të Prishtinës dhe të Beogradit që punojnë në pikëkalimet e përbashkëta vazhdon të jetë pozitiv dhe këmbimi i të dhënave elektronike doganore ndërmjet dy administratave tani është plotësisht funksional. Por për të krijuar regjistër civil gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në Kosovë ende nevojitet punë.

Megjithatë, perioda e raportimit është shënuar po ashtu edhe me ngadalësim të pjesshëm të zbatimit të marrëveshjes KOMPAKT 2, në veçanti lidhur me kapacitetet e institucioneve lokale. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe atyre financiare. Mbetet shqetësuese gjendja e përgjithshme e stafit dhe ajo financiare në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Si Këshillit Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës ju mungojnë kapacitetet dhe burimet për t'i zbatuar planet e tyre të veprimit për hartimin e akteve nënligjore. Në përgjithësi reformat pozitive strukturore dhe ndryshimet institucionale në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës kanë çuar tek pothuajse ndryshimi i plotë i anëtarëve të Këshillit në dy këshillat, e cila gjë ka ndikuar në dinamikën e punës së tyre dhe kjo kërkon përpjekje më të mëdha për ta ruajtur stabilitetin, konsistencën dhe vazhdimësinë e këtyre organeve. Njëra prej sfidave më të mëdha që mbetet është zbatimi i procesit të ri të përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe të prokurorëve, trajnimi i tyre dhe ri-planifikimi i sistemit të vlerësimit të punës.

Në mënyrë që paneli i dytë i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës të bëhet plotësisht funksional, paneli i ankesave ka nevojë për staf shtesë. Për shkak të mungesës të stafit lokal paneli i ankesave rrezikon të bëhet jofunksional. Njësoj, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka nevojë të punësojë gjyqtarë vendas shtesë dhe staf mbështetës. Kjo është thelbësore për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme që të mund të trajtojë numrin e madh të lëndëve. Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit i ka kushtuar vëmendje zotimit të përtërirë të Qeverisë së Kosovës për t'i siguruar në mënyrë adekuate burimet për institucionet relevante. Por në mënyrë që të trasohet rruga për EULEX-in që të tërhiqet nga fusha të caktuara, duhet të shihet përparim i dukshëm.

Sidoqoftë është arritur përparim lidhur me deklarin e pasurisë së zyrtarëve publikë edhe sa i përket bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Anti-Korrupsion dhe shoqërisë civile. Megjithatë, drafti i ri i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si edhe legjislacioni lidhur me sistemin disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jetë më në harmoni me praktikën më të mira të BE-së.

Për më tepër, Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka bërë shumë përparim prej periudhës së fundit të raportimit. BE-ja ka qenë shumë e shqetësuar lidhur me një rast të posaçëm të tre të burgosurve të profilit të lartë që e kanë zgjatur periudhën e suspendimit të përkohshëm të dënimit të lëshuar për trajtim mjekësor jashtë. Megjithatë, është pozitive që një qendër paraburgimi e cila nuk i plotësonte standardet e kërkuara të BE-së është mbyllur ndërsa një qendër tjetër e paraburgimit do të mbyllet sapo të bëhet funksional objekti i ri.

Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së/Zyra e BE-së dhe EULEX-i do të vazhdojnë t'i mbështesin institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit, përfshirë në lidhje me dialogun e strukturuar për sundimin e ligjit, udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe studimin e fizibilitetit. Këto procese vendimtare mund ta vendosin Kosovën fuqishëm në kornizën e politikave të BE-së për Ballkanin Perëndimor.

KOMPAKT 2, 14 maj 2015



JOINT RULE OF LAW COORDINATION BOARD

COMPACT 2

The Kosovo Rule of Law Institutions, the Head of the EU Office in Kosovo/EU Special Representative and EULEX Kosovo,

Acknowledging the achievements reached in the implementation of the Compact signed on 9 November 2012 as overseen by the Joint Rule of Law Coordination Board (JRCB);

Recognising the need for the Kosovo authorities to effectively cooperate with EULEX Kosovo and the EUSR/EU Office so that further progress is made in the rule of law sector to reach the goals of the Compact and to satisfy the requirements of Kosovo's visa liberalisation and EU accession aspirations;

Acknowledging the commitment of the Kosovo rule of law institutions to implement their existing strategies and plans for advancing the rule of law and to work with the EUSR/EU Office and EULEX Kosovo to advance the joint agenda; ensuring the readiness of rule of law stakeholders in Kosovo to deal with challenges beyond the current EULEX mandate.

Acknowledging the renewed commitment of the Kosovo rule of law institutions to make further progress towards sustainability and accountability, and to develop and strengthen an independent multi-ethnic justice system and a multi-ethnic police and

customs service that are free from political interference, corruption, respect human rights and adhere to internationally recognized standards and European best practices;

Reaffirming their joint commitment to work within the overall EU policy framework as defined in the Stabilisation and Association Process with Kosovo, including the Feasibility Study;

Reaffirming the willingness to contribute to a normalization of relations between Pristina and Belgrade and move forward with the implementation of agreements reached so far in the EU facilitated dialogue as well as any other agreement in the rule of law area reached in the future;

Taking due note of the full complementarity of the European Union assistance programmes for Kosovo with the overall objectives, concrete goals and specific activities foreseen under this *Compact*;

have agreed as follows:

1. The Kosovo institutions, assisted by the European Union through *inter alia*, EULEX Kosovo Instrument for Pre-Accession (IPA) projects and associated programmes of support, re-commit themselves to the following overall

Joint Rule of Law Objectives:

- Strengthening police, customs, correctional and judicial institutions across the entire territory of Kosovo, including in the north of Kosovo, for the benefit of all communities;
- Increasing the ability of Kosovo's rule of law institutions to deal with inter-ethnic crime, serious and organized crime and corruption;
- Enhancing the anti-corruption capabilities of Kosovo's institutions, particularly through the criminal justice system;
- Enhancing the accountability of all rule of law institutions by allowing institutions such as the Kosovo Judicial Council, the Kosovo Prosecutorial Council and the

Police Inspectorate of Kosovo as well as relevant internal structures to fully assume their roles in accordance with the law;

- Consolidating the strategic, operational and organizational management capacity of Kosovo's rule of law institutions to advance implementation of relevant legislation, strategies and action plans;
- Fostering a higher degree of ethnic inclusion and gender balance in the Kosovo rule of law institutions;
- Improving the responsiveness of Kosovo's rule of law institutions to concerns frequently raised by minorities in relation to public safety, accessibility and openness;
- Strengthening inter-institutional cooperation between prosecutorial bodies and law enforcement by facilitating a higher degree of communication between these institutions;
- Enhancing the ability of the relevant institutions in addressing outstanding property-related claims;
- Further developing of the Kosovo witness protection system;
- Implement agreements reached in the framework of the EU facilitated dialogue, including the use of the EUSR office to facilitate mutual legal assistance requests.

2. The undersigned endorse the jointly developed new Compact Actions, which set specific activities and concrete goals with measurable benchmarks in line with the stated overall Joint Rule of Law Objectives.


3. In pursuit of these overall Joint Rule of Law Objectives, the Head of the EU Office in Kosovo/EUSR, the Head of Mission of EULEX Kosovo, the Minister of Justice, the Chair of the Kosovo Judicial Council and the Chair of Kosovo Prosecutorial Council hereby pledge to meet regularly in the Joint Rule of Law Coordination Board to examine progress made and agree upon constructive, practical and coordinated action to resolve obstacles and advance technical progress, including in the following priority areas:

- i) Compact Actions implementation;

- ii) Rule of law requirements highlighted in the EU Visa Liberalisation Roadmap and the Commission Progress Report;
- iii) Legislation related to the rule of law;
- iv) Continuity in rule of law service delivery beyond the current EULEX mandate;
- iv) Reform priorities enumerated in Kosovo's Justice Sector Review.

4. The Kosovo institutions, the EUSR/EU Office and EULEX Kosovo reiterate their strong commitment to overcoming identified gaps and to allocating the necessary resources and focusing their work so as to reach the overall Joint Rule of Law Objectives as set out in this Compact.

Pristina, the 14 May 2015




Hajredin Kuçi
 Minister of Justice




Samuel Žbogar
 Head of the EU Office in Kosovo
 EU Special Representative



Gabriele Meucci
 Head of Mission
 EULEX Kosovo



Enver Peci
 Chair of the Kosovo Judicial Council





Aleksandër Lumezi
 Chair of the Kosovo Prosecutorial Council

POLICIA & DOGANA

Aktivitetet dhe Rezultatet

Ekulibri etnik në institucionet e sundimit të ligjit

Ligji për Shërbimin Civil thotë që së paku 10% e pozitave në institucionet e sundimit të ligjit duhet të rezervohen për personat që ju përkasin komuniteteve jo-shumicë në Kosovë dhe të cilët i plotësojnë kriteret specifike të punësimit. Në Policinë e Kosovës (PK) 10.70% e pozitave të stafit civil janë të zëna nga komunitetet jo-shumicë. Gjithsej, 16.21% e stafit të PK-së ju takojnë komuniteteve jo-shumicë, ndërsa numri i plotë i policëve është 16.98%. Ngjashëm, në Doganën e Kosovës (DK) 16.52% janë nga komunitetet jo-shumicë, ashtu siç është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket gjyqësorit, me rregulloret e reja janë bërë disa përmirësime lidhur me procedurën e rekrutimit dhe të gradimit. EULEX-i ka ofruar mbështetje gjatë tërë hartimit dhe zbatimit të këtyre proceseve.

Si institucion, PK-ja ka përqindjen më të lartë të oficerëve dhe të stafit civil nga komunitetet jo-shumicë. Ndërkohë, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) kanë filluar ta bëjnë rekrutimin e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të stafit tjetër mbështetës në Kosovën veriore. Megjithatë, ky proces, i cili pritet të kontribuojë në ekuilibrin më të mirë të përgjithshëm etnik, është ngadalësuar. Gjithsej 483 pjesëtarë të stafit nga Mbrojtja Civile Serbe janë integruar në institucione të ndryshme të Kosovës, kryesisht në Kosovën veriore, në pajtim me marrëveshjen e arritur gjatë dialogut të lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. 25 prej tyre janë bërë pjesë e Qendrës së Paraburgimit të Mitrovicës (QPM), e cila tani ka staf të mjaftueshëm por vazhdon të mos jetë etnikisht e balancuar.

Rregulloret e reja të cilat rrjedhin nga aprovimi i pakos së ligjeve (shih kapitullin 2, KGJK dhe KPK) kanë bërë disa ndryshime në procedurat e rekrutimit dhe të gradimit, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë përfaqësim të përshtatshëm të pakicave dhe atë gjinor në institucionet e sundimit të ligjit. Si rezultat, dy përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë (një serb i Kosovës dhe një boshnjak i Kosovës) dhe tri femra janë zgjedhur si anëtarë të rinj të KPK-së në dhjetor 2015. Në mars 2016, KPK ka filluar raundin e parë të rekrutimit për 22 prokurorë në pajtim me legjislacionin e ri; kanë aplikuar gjithsej 183 kandidatë, 55 prej të cilëve ishin femra dhe 4 ishin serbë të Kosovës. Për më tepër, KPK-ja e ka respektuar dispozitën kushtetuese për përdorimin e gjuhëve zyrtare e cila pasqyrohet në aktet nënligjore të aprovuara rishtazi, madje edhe përfshirë Rregulloren për Vlerësimin e Përmbushjes së Prokurorëve. Kjo do t'iu ofrojë pjesëtarëve të komunitetit jo-shumicë qasje më të mirë në procesin e gradimit meqë dokumentet përkatëse do të përkthehen në gjuhët e tyre.

Krimet ndëretnike

Krimet ndëretnike janë incidente të motivuara etnikisht siç janë krimet ndëretnike të urrejtjes dhe krimet që kanë ndikim të pabarabartë në komunitetet etnike pakicë. Në të gjitha institucionet e Kosovës për sundim të ligjit duhet të përmirësohet trajtimi i krimeve të tilla.

Këto institucione duhet të zhvillojnë sistem të harmonizuar për mbledhjen e të dhënave për krimet ndëretnike. PK-ja është institucioni i vetëm i cili ka procese institucionale për regjistrimin e incidenteve ose të krimeve të pretenduara. Janë duke u bërë përpjekje për krijimin dhe aprovimin e përkufizimit të kornizës së përbashkët të 'krimeve ndëretnike' dhe për praktikën e punës ndërmjet PK-së, Prokurorive të Shtetit, KPK-së dhe KGJK-së, me mbështetjen e EULEX-it. Është mbajtur një punëtori e lehtësuar nga EULEX-i për ta futur në përdorim një koncept të 'përkufizimit të kornizës së përbashkët' për krimet ndëretnike me qëllim që të përkufizohen qartë obligimet e institucioneve të sundimit të ligjit në këtë fushë dhe për të ndihmuar në krijimin e partneriteteve. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj nisme është promovimi i regjistrimit dhe i analizimit efektiv të incidenteve dhe të krimeve.

Deri më tani, PK-ja është institucioni i vetëm i sundimit të ligjit me Procedura Standarde të Operimit (PSP) lidhur me krimet apo incidentet ndëretnike. Për më tepër PK-ja është institucioni i vetëm i Kosovës që posedon kapacitet organizativ për t'i regjistruar krimet ndëretnike së bashku me të dhënat tjera përkatëse demografike. Megjithatë, mungesa e metodës së qartë të PK-së për t'i shënuar krimet potencialisht të motivuara etnikisht në praktikë çon tek një numër i vogël i rasteve të regjistruara, e cila nuk përputhet me monitorimin e EULEX-it në terren. Një arsye për numër të kufizuar të rasteve të regjistruara mund të jetë që rastet e tilla konsiderohen si shenjë e dështimit. Vetëm aktakuzat substanciale për krimet ndëretnike regjistrohen, duke e thjeshtësuar kështu një realitet shumë më kompleks. Në fund, kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e PK-së për të zbatuar qasje proaktive në luftën kundër krimeve ndëretnike.

Për më tepër, prokurorët nuk ia dalin t'i klasifikojnë si duhet veprat penale që kanë elemente ndëretnike, si vrasje e rëndë (neni 179 paragrafi 1.10 i Kodit Penal), ose dëmtim i pronës (neni 333 paragrafi 4 i Kodit Penal). Gjykatat nuk janë duke e shfrytëzuar paragrafin 2.12 të nenit 74 të Kodit Penal, me dispozitat e tij për faktorët rëndues të krimeve të urrejtjes, gjatë përcaktimit të dënimeve. Një dokument i përkufizimit të kornizës së përbashkët duhet të ndihmojë për t'i eliminuar mospajtimet e tilla dhe në përgjithësi për ta rritur ndërveprimin ndërmjet policisë dhe prokurorisë kur është fjala për hetimin e krimeve ndëretnike.

Inspektorati Policor i Kosovës

Ndonëse Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është i një rëndësie vendimtare për llogaridhënie të policisë, agjencia ende nuk është plotësisht operacionale: asaj i mungojnë burimet financiare dhe njerëzore. Kjo do të thotë se zyrat rajonale të hapura rishtazi në veri të Mitrovicës, Gjilan dhe Prizren nuk mund të funksionojnë si zyra rajonale hetimore të mirëfillta. Aktivitetet e tyre janë reduktuar thjesht në mbledhjen e ankesave, të cilat më pas përcillen për t'u përpunuar tutje në selinë qendrore të IPK-së në Prishtinë. Zvogëlimi i buxhetit të IPK-së dhe mos rritja e tij e rregullt vjetore mbetet një shqetësim i madh për këtë institucion gjatë fazës së ndërtimit të vet. Shkurtime të buxhetore ndikojnë dukshëm jo vetëm për themelimin e gjashtë zyrave hetimore rajonale sipas planit, por edhe në çështjet tjera të rëndësishme si, rekrutimi, mirëmbajtja dhe blerja e pajisjeve të domosdoshme, dhe zëvendësimi i automjeteve. IPK aktualisht i ka të plotësuar vetëm 80% të pozitave. Ndërsa, në maj 2016 është emëruar kryeshefi ekzekutiv i ri, në pajtim me të gjitha rregulloret përkatëse.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në mes të IPK-së, prokurorisë dhe gjykatave vazhdon të pengohet, kryesisht nga stërngarkesa e prokurorëve, burimet e pamjaftueshme dhe praktikat jo adekuate. Për dallim, bashkëpunimi në mes të PK-së dhe IPK-së vazhdon të vlerësohet pozitivisht. Për shembull, takimet e përbashkëta mbahen rregullisht me qëllim të rishikimit të planeve të IPK-së për inspektim, rezultate dhe rekomandime. Po ashtu, në mars 2016, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), ka iniciuar mbajtjen e takimeve bashkërenduese në nivel të Zëvendësministrit në mes të PK-së dhe IPK-së për rritjen e bashkëpunimit në çështjet e ndjeshme dhe të mosmarrëveshjeve që mund të dalin nga hetimet e zhvilluara nga IPK-ja.

Për sa i përket Ligjit për IPK-në, IPK-ja ka propozuar ndryshimet e reja në pajtim me rekomandimet e EULEX-it. Ligji i mëparshëm, shumë funksione nuk i ka përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, ndaj ka nevojë të harmonizohet me ligjet tjera, duke përfshirë Ligjin për Policinë. Propozimi i IPK-së ishte miratuar nga Departamenti Ligjor i MPB-së. Një dokument i konsoliduar do t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë (MD) e cila do të themelojë grupe punuese me palët me interes me qëllim të paraqitjes së komenteve për çdo nen të kodeve.

Sipas Raportit Vjetor të IPK-së për 2015, IPK-ja ka pranuar 1,237 ankesa dhe informacione për shkeljet potenciale të kryera nga policia (që është më pak për 5.4% krahasuar me 2014), të cilat kanë rezultuar në zhvillimin e hetimeve ndaj 220 policëve të PK-së (2.45% nga numri i përgjithshëm i fuqisë punëtore të PK-së). Deri më tani, 173 raste kanë rezultuar me hetime penale, 161 raste janë dërguar në prokurori, ndërsa 12 raste të mbetura janë bartur në vitin e ardhshëm. Aktakuzat penale janë ngritur për 108 raste, prej të cilave 24 raste prokuroria i ka proceduar në gjykatat kompetente. Në vitin 2015, gjykatat kompetente kanë shpallur gjithsej katër aktgjykime. PK-ja ka kryer 23 arrestime, ka lëshuar 39 rekomandime për suspendim dhe 11 rekomandime për transferim. Llojet më të shpeshta të rasteve të cilat janë hetuar më së shumti janë ato që kanë të bëjnë me rrezikimin e trafikut publik, keqpërdorimin e pozitës zyrtare, dhe shkaktimin e lëndimeve trupore të lehta. IPK-ja po ashtu ka trajtuar 11 raste të mitos dhe tetë raste të kanosjes.

Bashkëpunimi në mes të PK-së dhe Prokurorisë së Shtetit

Bashkëpunimi në mes të PK-së dhe Prokurorisë së Shtetit mund të vlerësohet si më i miri në kuptimin funksional. Ndërsa, ndërveprimi profesional ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Ndërveprimi i shtuar në mes të PK-së dhe Prokurorisë së Shtetit veçanërisht është i nevojshëm lidhur me hetimet për korrupsion, krim të rëndë dhe të organizuar si dhe hetime tjera serioze dhe të ndjeshme si terrorizmi, krimet e bazuara në urrejtje, krimet seksuale dhe krimet e dhunës në bazë të përkatësisë gjinore. Nga ana tjetër, implementimi i sistemit të ri për menaxhimin e rasteve në Prokurorinë e Shtetit tani është përfunduar. Ky është një sistem i dobishëm i TI-së i bazuar në gjurmim i cili aktualisht i monitoron 33 raste prioritare – raste të krimit të organizuar të nivelit të lartë dhe raste të korrupsionit – dhe është një hap përpara lidhur me bashkëpunimin në mes të prokurorisë dhe policisë. Organet tjera hetimore po ashtu janë të lidhura në këtë sistem dhe e shfrytëzojnë atë (tatimi, dogana dhe gjykatat).

BE-ja aktualisht është duke e zhvilluar një projekt nga "Instrumenti i Para-Anëtarësimin" (IPA), për Prokurorinë e Shtetit dhe PK-në, i quajtur 'Forcimi i kapaciteteve për hetimet penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit'.

PK-ja në pjesën veriore të Kosovës

Më 19 prill 2013 është nënshkruar Marrëveshja e Brukselit, e cila ka për synim normalizimin e raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Në njërin prej pikave të Marrëveshjes thuhet se PK-ja do të jetë forca e vetme policore në Kosovë, dhe të gjithë pjesëtarët e policisë në pjesën veriore të Kosovës duhet të integrohen. Me këtë marrëveshje është themeluar Drejtoria Rajonale e Policisë (DRP) me katër stacione të policisë për pjesën veriore të Mitrovicës, nga një për çdo komunë. DRP-ja e reflekton përbërjen etnike të rajonit, që është me shumicë serbe. Nga marsi 2014, me mbështetjen e EULEX-it, DRP-ja për pjesën veriore të Mitrovicës dhe katër stacionet e saj policore janë bërë operacionale dhe në gjendje për të ofruar kryesisht veprime policore të reagimit.

Në periudhën prej gusht 2015 deri qershor 2016, EULEX-i ka vazhduar me mbështetjen e vet për aftësitë e Kontrollit të Turmës dhe Trazirave (KTT) të Ekipeve për Reagim të Shpejtë (ERSH) në pjesën veriore të Mitrovicës. EULEX-i i ka zhvilluar disa trajnime me ushtrime të përbashkëta të aftësimin për KTT-të e ERSH-së në pjesën jugore të Mitrovicës dhe pjesën jugore të Mitrovicës që po ashtu ka shërbyer për avancimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të dy DRP-ve. Përkundër trajnimit dhe sigurimit të disa pajisjeve të reja, kapacitetet për KTT-së të ERSH-së në veri të Mitrovicës kanë mungesë të pajisjeve themelore.

Progres i njejtë është arritur në themelimin e Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca (PUI), që është një model i policimit i ndërtuar mbi mbledhjen dhe vlerësimin e informacionit i cili analizohet me qëllim të vendimmarrjes dhe menaxhimit të riskut për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve, dhe përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit operacional. Përkundër mbështetjes së fuqishme nga EULEX-i për implementimin e modelit të PUI-së në pjesën veriore të Kosovës, implementimi i saj efektiv gjatë aktiviteteve të përditshme të policisë ende ka nevojë për përmirësime. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës është plotësisht funksional në të gjitha katër stacionet e policisë në pjesën veriore. Mirëpo, policët e nivelit të stacionit kanë nevojë për trajnime shtesë për përdorimin e këtij sistemi. Ndërkohë, policët e PK-së kanë marrë pjesë në trajnimin për vlerësim të informacionit në qershor 2016.

Raportet në mes të PK-së në veri dhe PK-së në jug dhe nivelit qendror mund të përmirësohen edhe më shumë. Raportet dhe komunikimi në mes të DRP-së nga pjesa veriore e Mitrovicës dhe nivelit qendror janë përmirësuar, por nevojitet vëmendje e mëtejme. Komandantët rajonalë të PK-së për pjesën veriore dhe pjesën jugore të Mitrovicës, në rend të parë takohen në baza ad hoc dhe në bazë të nevojave operacionale. Në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më i qëndrueshëm, ai duhet të mbështetet në sistem, dhe të udhëhiqet në mënyrë më shumë proaktive sesa reaktive. Mirëpo, gjatë periudhës së raportimit, janë vërejtur përmirësime në këtë drejtim. Për shembull, Komandantët rajonalë të PK-së për pjesën veriore dhe jugore të Mitrovicës kanë bashkëpunuar në mënyrë të suksesshme në planifikimin e operacionit lidhur me gjykimin e Oliver Ivanović, si dhe në planet operacionale paraprake lidhur me aspektet e sigurisë për demonstratat e mundshme në afërsi të urës kryesore në Mitrovicë. PK-ja nga pjesa veriore dhe ajo nga pjesa jugore kanë bashkëpunuar në përgatitjen e planit vjetor të punës me qëllim të vendosjes së objektivave koherente në të dyja anët, si ofrimi i sigurisë dhe i lirisë së lëvizjes brenda hapësirës së urës kryesore.

Disa aktivitete të informimit të opinionit janë zhvilluar nga PK-ja e pjesës veriore si, konferencat për shtyp për hetimet e suksesshme dhe operacionet e suksesshme të bastisjeve. Mirëpo, ende mungon një fushatë e cila ka për synim kthimin e besimit në PK-në dhe sistemin e drejtësisë penale. EULEX-i i ka trajnuar 14 policë të nivelit të lartë për komunikim me popullatën lokale dhe zhvillimit të raporteve me mediat. Sa i përket policisë në bashkësi, Këshillat Lokale për Siguri Publike (KLSP) janë themeluar në fund të vitit 2014, me ndihmën e OSBE-së dhe kanë për qëllim avancimin e bashkëpunimit në mes të PK-së dhe popullatës lokale dhe ato janë zhvilluar edhe më shumë me ndihmën e EULEX-it. Një vlerësim për KLSP-të i kryer në maj 2016 ka gjetur se këshillat ende nuk janë duke funksionuar si duhet.

Përgjithësisht, mangësitë e identifikuara në aftësitë e tyre për menaxhimin e burimeve, përgjigjes efektive ndaj thirrjeve për shërbim, dhe ruajtjes së nivelit të llogaridhënies që shkon përtej qortimit, e pengon edhe më tutje përparimin e PK-së në pjesën veriore

Menaxhimi i kufirit

Dogana e Kosovës i ka përmirësuar rezultatet e veta gjatë vitit të kaluar. Të hyrat e mbledhura nga DK-ja arrijnë në më shumë se 70% të të gjitha taksave dhe të hyrave të mbledhura. Në fund të vitit 2015 u shënuar një rritje në të hyra prej 9.25% krahasuar me dhjetorin e vitit 2014. Mirëpo, targeti për të hyrat nga DK-ja i caktuar nga Qeveria e Kosovës për vitin 2016 prej më shumë se një miliardë eurosh paraqet një sfidë për DK-në, duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill dhe e cila do të rezultojë me rënie në të hyra prej 2% (përafërsisht 25 milionë euro). Megjithatë, të hyrat nga DK-ja për pesë muajt e parë të 2016 arrijnë në 20% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti paraprak. Numri i shkeljeve të vërejtura nga DK-ja për gjashtë muajt e parë të 2016 shënon një rritje prej 50% krahasuar me vitin paraprak.



Vendkalimi kufitar në Han të Elezit

Për arritjen e këtyre rezultateve të dalluara në mbledhjen e të hyrave dhe të arriturave tjera të shkëlqyera suksesi i takon reformave të reja, procedurave të përmirësuara dhe pajtueshmërisë së avancuar, bashkë me një numër të masave të rëndësishme anti-korrupsion të cilat janë implementuar rishtazi. Këto reforma përfshijnë edhe fillimin e punës së sistemit të ri dhe krejtësisht elektronik i cili promovon një lehtësim të shtuar komercial, duke e paraqitur Njësinë Qendrore të Verifikimit për zhdoganimin e mallrave, reformimin e depove doganore, krijimin e ekipit mobil të përputhshmërisë dhe themelimin e Zyrës së Përbashkët Doganore për Tranzit në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Bashkë me progresin e arritur në kuptim të lehtësimit të tregtisë dhe raporteve doganë-biznes, këto paraqesin zhvillime të rëndësishme në procesin e zhvillimit të DK-së dhe po ashtu demonstrojnë për rritje të transparencës me komunitetin e biznesit dhe publikun në përgjithësi. Thirrjet publike në linjën e veçantë telefonike në këtë vit janë rritur për 53%. Veç kësaj, janë dhënë iniciativa për arritjen e një barazie më të madhe gjinore në administratën e DK-së.

Me qëllim të luftimit të korrupsionit, DK-ja ka iniciuar një numër të rasteve disiplinore gjatë këtij viti, të cilat kanë rezultuar me suspendimin e zyrtarëve doganorë – disa prej tyre kanë qenë të përfshirë në raste penale. Këto reforma pozitive dhe sukcesi i përgjithshëm në mbledhjen e të hyrave demonstrojnë se DK-ja është njëra prej institucioneve më stabile dhe më të zhvilluara në Kosovë, me një legjislacion modern doganor dhe procedura të hartuara mirë, të cilat ofrojnë një shkallë të lartë të sigurisë, të mbështetura nga Sistemi i fuqishëm i Teknologjisë së Komunikimit.



Pikë kalimi në Merdarë

Qeveria e Kosovës e ka miratuar një plan fillestar për bashkimin e DK-së me Administratën Tatimore të Kosovës, duke krijuar një agjenci të vetme për të hyra. Ky është një përkushtim i madh i Qeverisë së Kosovës, ndaj edhe duhet të trajtohet me shumë kujdes, përmes asistencës teknike të siguruar nga partnerët ndërkombëtarë, e me qëllim të ruajtjes së stabilitetit buxhetor të Kosovës.

Pas një vit pritjeje, Qeveria e Kosovës ka emëruar Koordinatorin e ri Nacional për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) dhe procesi i implementimit të Planit Nacional për MIK dhe Planit për Zhvillimin e Qendrës Nationale për Menaxhimin e Kufirit, tani është në rrugë të drejtë.

FRONTEX-i dhe MPB-ja e kanë nënshkruar një Marrëveshje Pune për formimin e bashkëpunimit operacional. Kjo i mundëson FRONTEX-it dhe Qeverisë së Kosovës që të bashkëpunojnë në mënyrë më intensive në një numër çështjesh si, këmbimi i informacionit, operacionet e përbashkëta, trajnimi, dhe hulumtimi dhe zhvillimi. Departamenti për Kufi i PK-së do të luaj një rol kyç në implementimin e Marrëveshjes së Punës.

Kontrolli i Kufirit të gjelbër



Patrulla kufitare e Policisë së Kosovës

Policia Kufitare e Kosovës (PKK), DK-ja, EULEX-i dhe homologët serbë kanë vazhduar me mbajtjen e takimeve të rregullta në pikëkalimet e pjesës veriore. Në janar 2016, PKK-ja bashkë me EULEX-in filluan patrullimet në kufirin e gjelbër në komunën e Leposaviqit, të cilat rezultuan me disa arrestime lidhur me kontrabandën, kalimin ilegal ose drejtimin e mjeteve në gjendje jo të rregullt, si dhe transportin e kundërligjshëm të artikujve të ndryshëm. Patrullimet e përbashkëta filluan po ashtu edhe në komunën e Zubin Potokut. Mirëpo, stacionet e PKK-së në Leposaviq dhe Zubin Potok janë duke u ballafaquar me mungesë të personelit, pajisjeve dhe hapësirave të përshtatshme, të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në mundësitë e tyre për të funksionuar. Për shembull, patrullimet ishin anuluar në janar 2016 për shkak të mos pajisjes së PKK-së me automjete të duhura.

Sidoqoftë, dy automjete shtesë i janë dhënë PKK-së në pjesën veriore, sipas rekomandimeve të EULEX-it, të cilët duan të shohin më shumë patrullime. Normalizimi i plotë në mes të Beogradit dhe Prishtinës ende nuk është vendosur kur bëhet fjalë për politikën e Vijës Kufitare Administrative.

Mbrojtja e dëshmitarëve

Kërkesat organizative nga Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBS) lidhur me Udhërrëfyesin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve janë plotësuar dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve e PK-së (DMD) është e gatshme të merret me dëshmitarin e parë. Megjithatë, mbrojtja e dëshmitarëve, duke qenë një mjet esencial në luftimin e krimit të organizuar, është një funksion mbështetës i cili u përgjigjet nevojave gjatë procesit të ndjekjes penale. Në mënyrë që PK-ja të fillojë me operacionin e saj të parë, në mënyrë që ata të kenë mundësinë për të testuar dhe shqyrtuar funksionalitetin e tyre, ata duhet të vazhdojnë bashkëpunimin me të gjitha palët e përfshira nga sistemi i së drejtës penale në Kosovë. Kjo do të sigurojë një vetëdijësim lidhur me disponueshmërinë e tyre brenda sistemit dhe disponueshmërinë e tyre për mbështetjen e procesit të ndjekjes penale. Në shkurt 2016, KPK-ja mori iniciativën për të organizuar një tryezë të rrumbullakët për mbrojtjen e dëshmitarëve, me të gjitha palët me interes, me qëllim të sensibilizimit lidhur me mjetet e disponueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve. EULEX-i është i gatshëm të mbështesë DMD-në në kryerjen e operacioneve të veta të para.

Programi i financuar nga BE-ja për mbrojtjen e dëshmitarëve: "Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit" (origj. WINPRO) II ka përfunduar në korrik 2015. Brenda kornizës së këtij projekti janë mbajtur trajnime për njësitë për mbrojtjen e dëshmitarëve në Ballkan, një konferencë për Udhëheqësit e Njësive për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, dhe një konferencë e përgjithshme rajonale. WINPRO III për Ballkanin Perëndimor ka filluar më 1 shkurt 2016 dhe do të vazhdojë edhe për tre vite të ardhshme. WINPRO III synon të vazhdojë mbi punën e arritur gjatë viteve të kaluara në drejtim të zhvillimit dhe adresimit të çfarëdo nevojë për trajnime.

DREJTËSIA



Pallati i Drejtësisë

Aktivitetet dhe Rezultatet

Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHKK-ja ka shënuar pak progres që nga periudha raportuese e fundit. Sidoqoftë, në aspektin pozitiv, një qendër e paraburgimit në Prishtinë e cila nuk i plotësonte kushtet sipas standardeve të BE-së është mbyllur dhe një qendër e paraburgimit në Gjilan do të mbyllet së shpejti me funksionalizimin e qendrës së re në Gjilan.

Inspektorati i Brendshëm i MD-së i ka vlerësuar çështjet e lidhura me sigurinë në Burgun e Sigurisë së Lartë (BSL), ndërtimi i të cilit ishte financuar nga BE-ja dhe ka konkluduar se siguria, masat kundër kontrabandimit dhe menaxhimi i incidenteve janë të nivelit të kënaqshëm. BSL-ja, po ashtu i ka përmirësuar programet e aktiviteteve sportive për të burgosurit. Për më tepër, objektivat dhe veprimet e lidhura me trajtimin e të burgosurve, zhvillimin e stafit, dhe infrastruktura e strategjisë për BSL-në janë finalizuar; kjo i përfshin procedurat për mbajtjen e regjistrimeve të bisedave telefonike të të burgosurve.

BE-ja ka qenë shumë e shqetësuar për një rast të veçantë të tre të burgosurve të profilit të lartë për të cilët ishte pezulluar zbatimi i dënimit për shkak të trajtimit mjekësor jashtë vendit dhe kjo ishte bërë pa ndonjë vendim zyrtar për vazhdimin e pezullimit, ndërsa as kthimi i tyre nuk ishte zbatuar në mënyrë aktive nga Qeveria e Kosovës.

Dy raste të tilla kanë ndodhur në tetor 2015 dhe njëri në mars 2016. Kjo situatë e jashtëligjshme ka vazhduar për disa muaj, duke e treguar kështu brishtësinë e pranishme brenda zingjirit të drejtësisë penale në Kosovë.

Përkitazi me keqpërdorimin e vizitave spitalore në SHKK, BSL-ja e ka hartuar një procedurë për ruajtjen dhe mbikëqyrjen e të burgosurve gjatë vizitave spitalore. Mirëpo, keqpërdorimet gjatë vizitave spitalore kanë vazhduar të përcillen me një numër të parregullsive tjera si vizitat e paautorizuara të të burgosurve të profilit të lartë, ndërhyrjet politike, vendosja e personave të paraburgosur dhe të atyre që janë dënuar për kundërvajtje, bashkë me të burgosurit me dënime të gjata, dhe për korrupsion ose kontrabandë. Kjo e fundit është posaçërisht e evidente në Qendrën Korrektuese të Dubravës ku është vlerësuar se për çdo muaj zbulohen nga 20 telefona mobil. EULEX-i beson se numri i telefonave të kontrabanduar është shumë më i lartë se ky dhe prandaj e ka këshilluar SHKK-në që menjëherë të ndërmerr masa të fuqishme kundër kontrabandimit.



Qendra Korrektuese në Dubravë

Plotësimi me staf në SHKK mbetet një shqetësim duke ditur që rekrutimet e reja nuk parashihen për vitin 2016 për shkak të shtrëngimeve buxhetore. Mungesa e stafit, po ashtu paraqet kërcënim për stabilitetin operacional të BSL-së. Përkitazi me gjendjen e stafit, në BSL nuk ka mundësi të vendosen më shumë të burgosur. Në përgjithësi, BSL-ja ka nevojë edhe për 130 staf shtesë për të qenë në gjendje të kryej detyrat e veta operationale në mënyrë të duhur.

Çështjet e lidhura me prokurimin si anulimi i një numri të tenderëve të rëndësishëm për furnizim me artikuj ushqimor, mirëmbajtja e kamerave (CCTV) për BSL-në dhe sigurimi i akomodimit në spital, mbeten të zgjidhen.

Përmirësime të konsiderueshme dhe emergjente kërkohen lidhur me praktikën e prokurimit, të cilat aktualisht shkaktojnë vështirësi serioze si për të burgosurit ashtu edhe stafin e BSL-së.



Të burgosurit në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Ekziston nevoja për trajnimin e stafit; mirëpo, duket se ka mungesë vullneti për organizimin e kurseve trajnuese. Në të njëjtën mënyrë, planifikimi i dënimeve për të burgosurit dhe identifikimi i mundësive kuptimplota për punësimin e të burgosurve, po ashtu kanë shënuar vetëm një progres të kufizuar. Të burgosurit të cilët punojnë, në rend të parë angazhohen për pastrim dhe mirëmbajtje, ndërsa mundësitë ekzistuese dhe objektet për organizimin e punës prodhuese dhe rehabilituese, si dhe të punës profesionale, si për saldimit ose zdrukthëtarin për të burgosurit duket se janë përdorur pak për shkak të mungesës së lëndës së parë.

BE-ja aktualisht është duke e udhëhequr një projekt të IPA-s: “Mbështetje për Avancimin e Data-bazës së Shërbimit Sprovues të Kosovës”. Projekti synon modifikimin, zgjerimin dhe avancimin e bazës së të dhënave aktuale të Shërbimit Sprovues të Kosovës, me qëllim të sigurimit të shërbimeve më efikase dhe efektive.

Mitrovica Detention Centre

QPM operon relativisht mirë. Problemet me mungesë të stafit janë përmirësuar kryesisht falë integritetit të 25 pjesëtarëve të stafit të ardhur nga ish Mbrojtja Civile Serbe, sipas marrëveshjes nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja. Ata kanë filluar punën në QPM në nëntor 2015 dhe janë duke i kryer detyrat e veta në mënyrë profesionale. Stafin e rekrutuar rishtazi, janë të gjithë meshkuj që shpie deri te jo barazia gjinore brenda QPM-së, e që është një çështje që duhet adresuar.



Qendra e Parburgimit në Mitrovicë

Mungesa e trajnimeve dhe e pajisjeve, po ashtu mbetet një sfidë me rëndësi, që për rrjedhojë bën që QPM-ja të mos jetë në gjendje të caktojë stafin e ri në detyrat e përcjelljes së të burgosurve. Gjendja mund të përmirësohet duke marrë parasysh se Zyra e Kryeministrit e ka lejuar blerjen e pajisjeve të sigurisë (përfshirë edhe municionin), ndërsa çështja e servisimit të automjeteve është rregulluar pas nënshkrimit të kontratave të mirëmbajtjes. Për më tepër, Zyra e BE-së është duke e financuar ndërtimin e një tuneli në mes të QPM-së dhe Gjykatës Themelore që në një të ardhme të afërt do të lehtësoj përcjelljen e të burgosurve.



Gjykata Themelore e Mitrovicës

Mungesa afatgjatë e shumë-etnicitetit brenda QPM-së mbetet një shqetësim: pas shpalljes së pavarësisë në shkurt 2008, pjesëtarët shqiptarë të SHKK-së janë larguar për shkak të shqetësimeve të sigurisë dhe janë punësuar diku tjetër në kuadër të SHKK-së.

Që prej atëherë, pjesëtarët shqiptarë nuk janë rikthyer në QPM. EULEX-i, vazhdimisht e ka këshilluar SHKK-në për këtë çështje, mirëpo, kjo mbetet çështje e pazgjidhur për shkak të situatës së ndjeshme në Kosovë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës

Më 15 qershor 2015, janë bërë amandamentimet e pakos së ligjeve për gjyqësorin dhe ato kanë hyrë në fuqi, duke e përfshirë Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Pas kësaj, më 24 shkurt 2016, është ndryshuar Kushtetuta e Kosovës, lidhur me përbërjen e KGJK-së. Këto ndryshime adresojnë rekomandimet nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave, lidhur me emërimet, vlerësimet dhe përjashtimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe pavarësinë e gjyqësorit. Nga kjo, një numër i akteve nënligjore janë në pritje të miratimit. Këto duhet të miratohen nga KGJK-ja dhe KPK-ja brenda afatit prej gjashtë muajve. Mirëpo, përkundër afatit të datës 15 janar 2016 për përfundimin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të cilat dalin nga ndryshimet e ligjeve, ky proces ende nuk ka përfunduar. Në ndërkohë, aktet nënligjore të rëndësishme ende janë në formë të projektit. Për KGJK-në këto kanë të bëjnë me Rregulloren për Caktimin dhe Transferimin e Gjyqtarëve, Rregulloren për Gjyqtarët Porotë dhe Rregulloren për Politikën dhe Standardet e Trajnimit të Gjyqtarëve, Gjyqtarëve Porotë dhe të Stafit Gjyqësor tjetër. Për KPK-në, kjo ka të bëjë me Rregulloren për Strukturën Organizative dhe Funkcionimin e Sekretariatit të KPK-së.

Një vonesë serioze për hartimin e akteve nënligjore tregon se në të dy Këshillat ka mungesë të kapaciteteve dhe burimeve për ndjekjen e planeve të veprimit lidhur me hartimin e rregulloreve. Kjo po ashtu tregon se Komisionet Normative të këshillave kanë mungesë të stafit adekuat të kualifikuar për të hartuar rregulloret në mënyrë të pavarur dhe me kualitet të mjaftueshëm, të cilat dalin nga ligjet.

Përgjithësisht, reformat strukturore pozitive dhe ndryshimet institucionale në KGJK dhe KPK koincidojnë me ndryshimet e pakos së ligjeve të paraqitura nga mesi i vitit 2015 dhe ato i kanë kontribuar performancës relativisht të ulët të KGJK-së dhe KPK-së. Këto reforma kanë çuar pothuajse deri te një ndërrim i tërësishëm i anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së, që ka ndikuar në dinamikën e punës së tyre dhe që kërkon më shumë përpjekje për ruajtjen e stabilitetit, konsistencës dhe të vazhdimësisë, në të dy Këshillat.

KPK-ja me përbërjen e saj të re ka filluar së funksionuari në janar 2016, zgjedhja e tre anëtarëve të rinj nuk është bërë, në pritje të votimit nga Kuvendi i Kosovës. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të KGJK-së mbetet që të miratohet: kjo ligjërisht do ta themelon Sekretariatit. Rekrutimi i 22 prokurorëve të rinj nëpër Prokuroritë Themelore në Kosovë është duke vazhduar, një proces ky të cilin KPK-ja deri më tani e ka udhëhequr në mënyrë të qetë dhe profesionale.

Veç kësaj që u tha më lart, tani KGJK-ja ka një kryesues të ri dhe anëtarë të rinj të Këshillit nga Gjykata Supreme dhe Gjykatat Themelore. Për më tepër, një anëtar i Këshillit është përzgjedhur nga radhët e deputetëve të Kuvendit të cilët i kanë ulëset e rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb të Kosovës. Nga gjithsej trembëdhjetë pozita, dymbëdhjetë janë plotësuar. Si KPK-ja ashtu edhe KGJK-ja mund t'ia atribuojnë vetes menaxhimin e ndryshimeve në përbërjen dhe lidhshimin e tyre brenda afateve kohore dhe duke e respektuar legjislacionin e zbatueshëm. Deri më tani, të dy Këshillat për të qenë funksionale e kanë ruajtur kuorumin e nevojshëm.

Njëra prej sfidave më të mëdha për KGJK-në mbetet implementimi i procesit të ri për përzgjedhjen e gjyqtarëve, që mes tjerash, përfshin administrimin e testeve të ndërlikuara me shkrim, dizajnimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarët, dhe ridizajnimin e sistemit për vlerësimin e performancës.

Lidhur me mekanizmat gjyqësor të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, progresi është arritur me ndryshimet e fundit të Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit për KPK-në. Mirëpo, ende ka nevojë për zhvillimin e duhur të kornizës ligjore për Zyrën e Prokurorit Disiplinor, ndërsa aktet nënligjore përkatëse duhet të finalizohen, dhe të zbatohen mekanizmat ekzistues të llogaridhënies.

Për më tepër, vendosja e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Rasteve (origj. CMIS) dhe me këtë edhe të mundësisë së mbledhjes të të dhënave të besueshme është ende në pritje të funksionalizimit të plotë të CMIS, i cili pritet të jetë operacional nga viti 2018 e tutje, siç është paraparë me planin e veprimit të tyre. Përderisa Ligji për Shkelje të Vogla do të zvogëloj numrin e rasteve të grumbulluara, ai në përgjithësi nuk do ta zgjidhë problemin. I gjithë procesi është ende njësoj sfidues. Adresimi i rasteve të grumbulluara brenda sistemit gjyqësor të Kosovës mbetet sfidë.

Luftimi i korrupsionit

Edhe pse sistemi i deklarimit të pasurisë kërkon rishqyrtim të thukët, vlen të ceket se është shënuar progres i caktuar lidhur me këtë sistem, përmes krijimit të dy mekanizmave të rëndësishëm kundër korrupsionit, gjegjësisht një videoje informuese televizive, ku njoftohen të gjithë zyrtarët e lartë publikë përkitazi me afatin e fundit për deklarimin e pasurisë, dhe letrës njoftuese e hartuar së bashku nga OSBE-ja dhe EULEX-i, e cila do të shërben si dëshmi se zyrtarët e lartë publikë janë njoftuar lidhur me obligimin e tyre për deklarimin e pasurisë. Pritet që përmes këtyre veprimeve do të përkrahet sistemi i deklarimit të pasurisë i zbatuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK).

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes AKK-së dhe shoqërisë civile ka shënuar progres të caktuar. Në bazë të analizës së një OJQ-je shihet se AKK-ja ka filluar procedurat paraprake hetimore sipas detyrës zyrtare lidhur me caktimin e një numri të madh të bordeve të drejtorëve në ndërmarrjet publike në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike. Lidhur me këtë çështje, AKK-ja ka dhënë një mendim drejtuar Zyrës së Kryeministrit. BE-ja ka përkrahur fuqimisht qëndrimin e AKK-së.

Sistemi i trajtimit të konfliktit të interesit kryesisht mbetet i paefektshëm. Qeveria e Kosovës tërhoqi nga Kuvendi i Kosovës projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe aktualisht janë duke punuar në një projektligj të ri. Megjithatë edhe ky dokument përmban mangësi, siç është ajo e lejimit të zyrtarëve që njëkohësisht të kenë më shumë se dy vende të punës, dhe ka nevojë që të harmonizohet më shumë me praktikën më të mirë të BE-së.

Ngjashëm me këtë, legjislacioni për sistemin disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët ende nuk është harmonizuar plotësisht me standardet ndërkombëtare, dhe Ligji për zyrën e prokurorit disiplinor ende nuk është finalizuar. Përveç kësaj, performanca e Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD) ka shënuar rënie, dhe sasia dhe cilësia e përgjithshme e hetimeve disiplinore të kryera nga ZPD-ja është e ulët.


Mekanizmi për shqyrtim të legjislacionit i përkrahur nga BE-ja ka dhënë komentet për projektligjin për prokurimin publik nga pikëpamja e luftimit të korrupsionit, dhe i ka paraqitur ato zyrtarisht përmes opinionit të konsoliduar juridik, i cili u është paraqitur autoriteteve të Kosovës.

Në kuadër të këtyre komenteve janë trajtuar çështjet e caktimeve, suspendimeve, dhe largimeve të anëtarëve të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik për qëllime të transparencës dhe integritetit të procesit. Shumica e komenteve të dhëna nga BE-së janë përfshirë në ligjin e ri, të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në shkurt të vitit 2016.

Agjencia Kosovare e Pronës

Deri në fund të dhjetorit 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP) i Kosovës kishte finalizuar gjithsej 42,749 kërkesa pronësore, duke përfunduar kështu punën e vet në mënyrë të suksesshme. Megjithatë, në qershor 2016 ende kanë figuruar edhe 648 vendime të KKP-së që nuk u janë dërguar palëve. Shumë nga këto raste mund të apelojnë në Panelin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP).

Paneli i ankesave i AKP-së i shqyrtton ankesat e parashtruara kundër vendimeve të KKP-së lidhur me ankesat pronësore të parashtruara tek AKP-ja. Që nga gushti i vitit 2015, Paneli i ankesave i AKP-së ka pranuar 150 ankesa të reja dhe ka nxjerrë 178 vendime. Në qershor, AKP ende i ka pasur edhe 417 raste të pashqyrtuara.



Paneli ankesave i AKP-së ia ka filluar punën me dy panele paralele (me nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe nga një të Kosovës për secilin) në nëntor të vitit 2015, duke rritur kështu numrin e lëndëve për të cilat është dhënë vendimi (siç është paraqitur edhe në grafikun më lartë). Megjithatë, sipas Ligjit për juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, dhe marrëveshjes për lëndët civile, lëndët në proces të pranuar pas datës 30 maj 2014 do të gjykohen nga paneli i përbërë me shumicë të gjyqtarëve vendorë. Kjo rezulton me vetëm një panel funksional pasi që të dy gjyqtarët vendorë kërkohen të jenë në të njëjtin panel.


Më 16 dhjetor 2015, KGJK-ja miratoi një vendim ku refuzohej kërkesa e përgjithshme e EULEX-it që Paneli i ankesave i AKP-së të përbëhet prej shumicës së gjyqtarëve të EULEX-it për rastet e regjistruara pas 30 majit 2014, si dhe ku parashihej që për secilin rast EULEX-i duhet të kërkojë përbërje me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it. Duke marrë parasysh se shumica e parashtruesve të kërkesave në Panelin e kërkesave të AKP-së janë të etnisë joshqiptare dhe se shumica e rasteve përfshijnë aspektin e ndjeshëm ndëretnik, EULEX-i ka kërkuar në 82 raste nga KGJK-ja lejimin që Paneli i ankesave i AKP-së të përbëhet nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it për lëndët e pranuar pas datës 30 maj 2014, prej të cilave KGJK-ja i ka miratuar 34.

Paneli i ankesave i AKP-së, për shumicën e rasteve ku shumica e anëtarëve nga EULEX-i nuk është e mundur, tani prapë punon vetëm me një panel. Paneli i ankesave i AKP-së rrezikon të bëhet jofunksional për shkak të mungesës së punonjësve vendorë, posaçërisht për faktin se njëri nga dy gjyqtarët vendorë do të pensionohet vitin e ardhshëm.


Pasi që AKP-ja ende nuk ua ka dorëzuar palëve 648 vendime të KKPK-së dhe deri më tani 2555 kërkesa janë dërguar vetëm përmes publikimit në media dhe ende mund t'iu dorëzohen paditësve me kërkesë të tyre, ka mundësi që palët në ato kërkesa të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për ankesë. Me qëllim të shqyrtimi të atyre ankesave, parashihet që përmes Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i cili është në pritje të miratimit nga Kuvendi, të barten kompetencat e AKP-së tek Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Kjo do të thotë se Agjencia e re do të jetë përgjegjëse për organizimin e rigjykimit nga Komisioni i ankesave pronësore në rast se Gjykata Supreme urdhëron rigjykimin e rastit.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Gjyqtarët vendorë dhe ata të EULEX-it kanë vazhduar shqyrtimin e rasteve në panele të përziera, ku gjyqtarët vendorë kanë qenë shumicë. Numri i përgjithshëm i rasteve të pazgjidhura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS) është rritur në 21,564– ose për 5.81% – nga gushti i vitit 2015 deri në qershor 2016, siç ilustron edhe në grafikun në të djathtë.



Numri i rritur i rasteve të mbyllura (siç ilustron në grafikun në të majtë) ka ardhur si rezultat i përpjekjeve të EULEX-it në përmirësimin e komunikimit mes punonjësve të KGJK-së me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së përgjithshme të punës dhe të zbatimit të procedurave standarde për trajtimin e dosjeve të rasteve. Për më tepër, KGJK-ja me sukses i plotësoi dy vende të lira të punës me dy gjyqtarë vendorë, të cilët tani kontribuojnë në rritjen e numrit të rasteve të zgjidhura nga DhPGJS.



DhPGJS vazhdoi me punë të suksesshme përkundër një numri sfidash, siç është koha e tejzgjatur e përpunimit për shkak të cilësisë jo të duhur të kërkesave të paraqitura dhe dorëzimeve të gjata të parash-trësive nga gjykata (si rrjedhojë e ndërprerjes së shërbimit të

ndërsjellë juridik) tek palët që jetojnë jashtë Kosovës, posaçërisht për ato që jetojnë në Serbi. Po kështu, numri i përgjithshëm prej 20 gjyqtarëve, siç parashihet me Ligjin për DhPGJS, është i pamjaftueshëm për trajtimin e një numri të madh të rasteve të reja dhe të atyre në pritje të vendimit. Në qershor të vitit 2016, njësia e përkthimeve në DhPGJS raporton një numër prej 31,087 faqe për përkthim. Rrjedhimisht, pritet që puna të rritet edhe më shumë, megjithatë, në kuadër të masave për zbutjen e vëllimit të punës, DhPGJS-ja aktualisht është duke përmirësuar rrjedhën e punës në sekretari dhe duke konsoliduar procesin e marrjes së vendimeve. Panelet janë të përqendruara në ekonomizimin e procedurave (siç është mundësia për marrjen e vendimeve në raste të caktuara pa seancë dëgjimore në raste të caktuara, identifikimi i rasteve me palë apo me tema të ngjashme dhe trajtimi i përbashkët i tyre, krijimi dhe përdorimi i shabllonëve të duhura), dhe shfrytëzimi i punonjësve ndihmës dhe i burimeve të tjera me qëllim të arritjes së rezultateve të efektshme. Pjesëmarrja e rregullt e gjyqtarëve të DhPGJS-së në diskutime juridike në Sesionet e përgjithshme të Gjykatës Supreme ende nuk është realizuar, ashtu siç parashihet me ligj, për shkak të mungesës së komunikimit në mes Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryetarit të Dhomës së Posaçme. Kjo në mënyrë të tërthortë ndikon në shkallën e zgjidhjes së rasteve pasi që gjyqtarët e DhPGJS nuk kanë mundësinë e diskutimit të çështjeve në sesionet e përgjithshme.

Megjithatë, është shënuar progres sa i përket standardeve të caktuara nga BPBSL: përzgjedhja dhe caktimi i dy gjyqtarëve vendorë dhe një këshilltari ligjor vendor ka përfunduar.

Dy projekte të EULEX-it janë realizuar me qëllim të hartimit të një doracaku me përmbledhje të rasteve kryesore për homologët vendorë, si dhe është dhënë një komentari lidhur me Ligjin për Dhomën e Posaçme, i cili përmban udhëzime për shqyrtimin e rasteve. Botimi i parë i përmbledhjes së jurisprudencës përmban 25 vendime/aktgjykime, dhe është botuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në maj të vitit 2016. Qëllimi i të dy projekteve është përmirësimi i efektshmërisë dhe cilësisë së procedurave gjyqësore dhe konsolidimi i shqyrtimit të rasteve në DhPGJS.




Seanca gjyqësore në proces

ZBATIMI I DIALOGUT

Aktivitetet dhe rezultatet

Regjistri civil

Përderisa krijimi i një regjistri civil gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në Kosovë në përputhje me Marrëveshjen e Dialogut për Librat e Regjistrimit Civil (LRC) në Kosovë ende kërkon punë, komunitat vazhdojnë t'i përdorin Kopjet e Vërtetuara (KV) në mënyrë jokohërente, duke shfaqur kështu nevojën për një qasje të përbashkët dhe udhëzime për përdorimin e kopjeve të vërtetuara në përputhje me udhëzimin administrativ.



Kopjimi i librave të Regjistrimit Civil të Kosovës, Nish Serbi

Tani për tani fokusi kryesor është vënë mbi digjitalizimin e të gjithë regjistrave të gjendjes civile, duke përfshirë kopjet e vërtetuara, dhe krijimin e arkivit elektronik. Idealisht kjo do të duhej të krijonte një sistem të regjistrimit të gjendjes civile në Kosovë i cili do të ishte plotësisht i kërkueshëm dhe i njësuar, dhe i cili do t'i përmbante të gjitha të dhënat dhe të përditësohej vazhdimisht, me të dhëna të sakta për të gjitha zhvillimet, siç janë lindjet, martesat, dhe vdekjet. Ky sistem digjital i regjistrimit të gjendjes civile nuk do t'iu shërbejë vetëm qytetarëve, por edhe institucioneve të tjera, si organeve për zbatimin e ligjit, entiteteve të prokurorisë, dhe Komisioni Qendror Zgjedhor. Për të siguruar integrimin e të gjitha këtyre të dhënave, të gjitha palët duhet të synojnë një qasje gjithëpërfshirëse me një perspektivë afatgjatë.

Lidhur me digjitalizimin, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) aktualisht është duke e ndryshuar Udhëzimin administrativ nr. 09/2015 për përcaktimin e procedurës së digjitalizimit të regjistrave themelorë të skanuar të gjendjes civile. Siç është rekomanduar nga EULEX-i, ndryshimet tani përfshijnë dhe mbulojnë procesin e përputhjes dhe ndërlidhjes së të dhënave për qëllime të ndryshme dhe për verifikim. Kështu që, Procedurat ekzistuese Standarde të Veprimit (PSV) do të kenë bazën e nevojshme ligjore.

Gjatë muajve prill dhe maj të vitit 2016, EULEX-i ka rivlerësuar funksionalitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) dhe institucioneve për zbatimin e ligjit, si dhe progresin e arritur nga të dyja palët sa i përket përgatitjeve teknike për mundësimin e këmbimit të informatave përmes shërbimeve të internetit apo zgjidhjeve të tjera në internet. EULEX-i erdhi në përfundim se lidhjet nuk janë krijuar apo nuk janë plotësisht funksionale ashtu siç parashihet në marrëveshje dhe në PSV. Rrjedhimisht, kjo do të ketë efekt negativ tek ARC-ja dhe institucionet për zbatimin e ligjit në aftësinë e tyre për parandalimin e aktiviteteve kriminale, pasi që informatat kryesore rreth ndryshimit të emrave, rreth pasaportave dhe automjeteve mund të mos këmbehen me kohë.

Në Kosovën veriore ekziston nevoja bazike për themelimin e shërbimeve të mirëfillta të gjendjes dhe regjistrimit civil si dhe të regjistrimit të automjeteve. Edhe pse serbët e Kosovës gjithnjë e më shumë po aplikojnë për dokumente të gjendjes civile të Kosovës, komunat e veriut ende nuk përdorin dokumentacionin e Kosovës, përfshirë këtu targat e automjeteve. Përmirësimet në këtë pjesë në masë të madhe varen nga progresi i mëtejshëm në dialogun e lehtësuar nga BE-ja për librat e regjistrimit civil dhe lirinë e lëvizjes.

Në shkurt të vitit 2016, panelet përzgjedhës filluan me integrimin e 77 ish-punonjësve administrativë të MUP-it në shërbimet e gjendjes civile dhe të regjistrimit civil të Kosovës. Prishtina propozoi që në ARC të integrohen 32 individë, pra në Qendrën për Lëshimin e Dokumenteve (letërnjoftimeve, pasaportave, dhe patentë shoferëve) dhe në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve, si dhe 45 punonjës në zyrat komunale të gjendjes civile. Procesi i integrit në ARC/MPB ka përfunduar: 32 ish-punonjës të stafit administrativ të MUP-it kanë nënshkruar kontratat dhe kanë vijuar trajnimet e duhura profesionale. Derisa integrimi i grupit të dytë, ku tani kanë mbetur vetëm 39 ish-punonjës administrativë të MUP-it (fillimisht kanë qenë 45, por tre prej tyre ishin më të vjetër se 65 vjeç dhe tre kanë refuzuar të caktohen), në autoritetet komunale në kuadër të shërbimeve të gjendjes civile ende ishte në vazhdim e sipër në qershor.

Liria e lëvizjes

Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për automjete ka pasur efekte pozitive në zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes. Sipas kësaj marrëveshjeje, ngasësit e automjeteve të regjistruara në territorin e njëjës palë, të cilët kanë sigurimin e vlefshëm për territorin e palës tjetër mund të hyjnë dhe të udhëtojnë lirshëm në atë juridiksion. Rrjedhimisht, qytetarët e Kosovës nuk duhet të paguajnë tarifa shtesë me rastin e



MIK – pike kalimi në Jarinjë

udhëtimit në Serbi. Që nga hyrja e kësaj marrëveshjeje në fuqi më 12 gusht 2015, zbatimi i saj ka shkuar mirë dhe nuk ka pasur ndonjë incident të madh.

Menaxhimi i integruar i kufirit

Menaxhimi i integruar i kufirit vazhdon të shënon progres. Bashkëpunimi mes Prishtinës dhe Beogradit lidhur me pikat e përbashkëta të kalimit vazhdon të jetë pozitiv. Këmbimi elektronik i të dhënave doganore në kohë reale përmes përdorimit të sistemit të Këmbimit Sistemik Elektronik të Dhënave (KSEDh) mes dy administratave doganore është negociuar me sukses brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe tani është plotësisht funksional. Ky është i vetmi këmbim elektronik i informatave mes Prishtinës dhe Beogradit.



MIK – pikë kalimi në Jarinjë

Çështja e mosnjohjes nga Beogradi i certifikatave ADR¹ të Kosovës për transportin e mallrave të rrezikshme është zgjidhur, dhe në prill të vitit 2016 të dyja palët janë pajtuar për kalimin e papenguar të mallrave të tilla.

Për më tepër, janë realizuar edhe takimet e para mes dy autoriteteve kufitare (policisë, doganave dhe inspektoratit fito-sanitar dhe atij të veterinarisë) si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd. Këto takime kanë qenë njëkohësisht edhe takimet më të madha të përbashkëta mes Policisë kufitare të Kosovës dhe Policisë së Serbisë që nga nënshkrimi i Protokollit teknik të MIK-ut më 23 shkurt 2012.

Janë nënshkruar kontrata mes BE-së dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) në Beograd dhe Prishtinë për ndërtimin e gjashtë vendkalimeve të përhershme.

¹ European Agreement on the International Carriage of Dangerous Goods by Road

Derisa Prishtina i ka përcaktuar të gjitha procedurat, dhe fillimi i ndërtimit të tri vendkalimeve nga ana e Prishtinës parashihet të bëhet para fundit të vitit 2016, progresi i Beogradit në këtë drejtim ishte vonuar deri në nxjerrjen e vendimit të qeverisë për themelimin e institucionit të ri përgjegjës për të gjitha vendkalimet (Administrata e shërbimeve të përbashkëta e organeve të republikës), gjë e cila u realizua më 27 prill 2016.

Megjithatë, një numër çështjesh të MIK-ut ende kanë mbetur të pazgjidhura, duke përfshirë problemet e kahmotshme infrastrukturore në vendkalimin Jarinjë/Rudnicë, si dhe përdorimi i vazhdueshëm nga ana e Beogradit i vulave paralele doganore.

Integrimi i strukturave të sigurisë

Në marrëveshjen e parë të vitit 2013 është paraparë integrimi i "strukturave serbe të sigurisë", ndërsa në marrëveshjen vijuese të marsit 2015 në mënyrë specifike shtjellohet integrimi i ish-mbrojtjes civile serbe. Procesi i integritit ka përfunduar në vitin 2016, përkundër disa sfidave, siç ishte bashkëndimi i mbi 20 institucioneve të Kosovës të përfshira në proces.

Në marrëveshje është paraparë integrimi i 483 ish-pjesëtarëve të mbrojtjes civile në institucione dhe ministri të ndryshme të Kosovës. Pas procesit të përzgjedhjes, deri në janar të vitit 2016 të gjithë ish-pjesëtarët e mbrojtjes civile kanë nënshkruar kontrata me institucionet e Kosovës, ku 50 ish-pjesëtarë të mbrojtjes civile janë integruar në fondin e kontingjencave përmes nënshkrimit të deklaratës formale. Deri në fund të vitit 2016, këta 50 zyrtarë do të caktohen në poste të përhershme. Pagesa e pagave me kohë u dëshmuua të jetë sfiduese, pasi që Ligji për buxhetin e vitit 2016 është dashur të miratohet para kohës. Institucionet e Kosovës që pranojnë punonjës të ri në katër komunat veriore të Kosovës do të hapin zyra të reja në Kosovën veriore. Një grup punues nën drejtimin e Ministrisë së Administratës Publike është duke shqyrtuar mundësitë e gjetjes së zyrave për ish-punonjësit e integruar të mbrojtjes civile.

Trajnime informuese dhe kurse të tjera të specializuara janë mbajtur për të siguruar integrimin e ish-pjesëtarëve të mbrojtjes civile në institucionet e Kosovës. Pala kryesore në këtë aspekt ka qenë OSBE-ja, e cila ka organizuar trajnime informuese njëjavore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Pas përfundimit të trajnimeve informuese, nga mesi i marsit 2016 janë mbajtur edhe kurse të trajnimeve të specializuara. Zyra e PSBE/BE ndërmori detyrën e mbajtjes së këtij trajnimi të specializuar dhe të përshtatur sipas nevojave, si dhe përkthimin e legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratën Publike.

Pjesëtarët e integruar tashmë kanë dhënë kontribute pozitive në institucionet e Kosovës, në veçanti në QPM, Agjencinë për Menaxhim të Emergjencave, në DK, dhe në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës.

Të gjitha shenjat e pranisë së mbrojtjes civile në veri tashmë janë shpërbërë. Kamerat e vëzhgimit dhe pikat e observimeve janë hequr. Xhaketat dhe veturat zyrtare të MC po ashtu janë hequr.

Drejtësia

Arritje të mëdha janë shënuar në lidhje me pikën 10 të marrëveshjes së parë, e cila e përfshin integrimin në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës të strukturave të gjyqësorit të drejtuar nga Serbia.

Ndërtesa e Jugobankës në Mitrovicën jugore në të cilën pritet të vendoset departamenti për lëndë civile i Gjykatës Themelore të Mitrovicës është rinovuar gjatë verës së vitit 2015. Lokacioni ku mendohet të vendoset Prokuroria Themelore në Mitrovicën veriore është identifikuar në tetor të vitit 2015, dhe pas dhënies së buxhetit nga KPK ai është duke u rinovuar.

Në bashkëpunim të ngushtë me KGJK dhe KPK, EULEX-i ka ndihmuar në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve, prokurorëve, dhe punonjësve mbështetës serbë të Kosovës. Gjithsej 34 gjyqtarë dhe 11 prokurorë janë përzgjedhur në vitin 2015 dhe 20 pozita të tjera (14 për gjyqtarë dhe 6 për prokurorë) janë shpallur në vitin 2016. Nga ky proces i përzgjedhjes, janë përzgjedhur 11 gjyqtarë dhe 3 prokurorë. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e përzgjedhur kanë qenë në pritje të caktimit në qershor të vitit 2016.



Më 29 mars 2016 janë shpallur 149 pozita të stafit mbështetës (115 për gjykatat dhe 34 për prokuroritë në mbarë Kosovën). Në qershor 2016 procesi i punësimit ende ka qenë në proces e sipër. Të gjitha palët e përfshira kanë si qëllim përmbylljen e tërë procesit të integritimit në vjeshtë të vitit 2016.

Njësia e PK-së për trashëgimi fetare dhe kulturore

Numri i përgjithshëm i incidenteve në Kosovë ka mbetur pothuajse i njëjtë krahasuar me periudhën raportuese të kaluar që është mbuluar me raportin e progresit të kompaktit (korrik 2014 – korrik 2015), me vetëm një incident më shumë. Gjatë muajve të kaluar janë regjistruar gjithsej 40 raste të vjedhjeve apo dëmtimeve ndaj lokacioneve fetare (39 gjatë periudhës raportuese të kaluar), 27 kundër lokacioneve myslimane, 7 kundër lokacioneve ortodokse, dhe 4 kundër lokacioneve katolike (dhe 2 kundër lokacioneve të tjera). Shumica e rasteve kanë të bëjnë me ‘vjedhje’ (25 raste), çka sugjeron se kryerësit kanë për motiv përfitimet materiale e jo ‘dëmtimet’ (14 raste), ku për këto të fundit do supozohej se do të ishin indikacion i ‘motiveve të urrejtjes, motiveve fetare apo etnike’ dhe indikacione të kërcënimeve të sigurisë kundër lokacioneve fetare. Vazhdon të ketë nevojë për t’i siguruar të gjitha lokacionet, në veçanti nëpër zonat rurale ku shkalla e incidenteve është më e lartë, dhe për të pasur patrullime policore efektive. Megjithatë, numri i incidenteve ka shënuar rënie të vazhdueshme, me gjithsej 11 raste të raportuara në janar, dhe vetëm 3 raste të raportuara në qershor 2016. Vlen të theksohet se shumica e rasteve kanë ndodhur në lokacione fetare që nuk janë nën fushëveprimin e Njesisë për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore (NjTFK). NjTFK ofron siguri vetëm për 24 lokacione kulturore fetare të Kishës Ortodokse Serbe me prani 24/7 të policëve nëpër pika statike. KFOR-i ende është përgjegjës për ofrimin e sigurisë në manastirin e Deçanit, lokacion ky i shënjestruar shpesh.

Në prill 2016, vlerësimi i rrezikut për lokacionet fetare ortodokse nga ana e PK është vonuar prapë dhe kërkon përditësim. Sipas “urdhrit operacional për ruajtjen dhe mbrojtjen e lokacioneve të trashëgimisë ortodokse serbe”, këto vlerësime kërkohen çdo gjashtë muaj. Për më tepër, PK duhet të zhvillojë një metodologji të re të vlerësimit të rrezikut në përputhje me standardet evropiane. Për shkak të nevojave të identifikuara, EULEX-i ka themeluar një task forcë të përkushtuar për zhvillimin dhe zbatimin e një metodologjie të re të vlerësimit të rrezikut, në përputhje me standardet evropiane.

Në përgjithësi, NjTKF është duke i përmbushur kriteret e veta të performancës sa i përket diversitetit të përbërjes së stafit, procedurave të raportimit, nivelit të inspektimit, dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive. Kjo njësi ka krijuar bashkëpunim të mirë me komunitetet fetare (komunitetin islamik dhe Kishën Ortodokse Serbe), PK-në, komunat dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
KV	Kopjet e Vërtetuara
CMIS	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Rasteve
V	Vendkalimet
ARC	Agjencia për Regjistrimin Civil
LRC	Librat e Regjistrimit Civil
KTT	Kontrolli i Turmave dhe Trazirave
PSBE	Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë
LR	Liria e Lëvizjes
BSL	Burg i Sigurisë së Lartë
MIK	Menaxhim i Integruar i Kufirit
PBI	Policimi i Bazuar në Inteligjencë
IPA	Instrument i Paraaderimit
BPBSL	Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit
PKK	Policia Kufitare e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KKPK	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
KLSP	Këshillat Lokalë për Siguri Publike
QPM	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MUP	Ministria e Punëve të Brendshme në Serbi /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës

ERSh	Ekipi për Reagim të Shpejtë
NjTFK	Njësia për Trashëgimi Fetare dhe Kulturore
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DhPGjS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
SEED	Këmbimi Sistemik Elektronik i të Dhënave
PSV	Procedura Standarde e Veprimit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
DPD	Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

European Union Rule of Law Mission

Partnership for Justice



www.eulex-kosovo.eu



www.twitter.com/eulexkosovo



www.facebook.com/eulexkosovo



www.youtube.com/eulexkosovo